

LIGJ
Nr. 74/2024

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MARRËVESHJEN
PËR THEMELIMIN E ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË VRESHTARISË
DHE VERËS (OIV)**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në marrëveshjen për themelimin e Organizatës Ndërkombëtare të Vreshtarisë dhe Verës (OIV) sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 25.7.2024.

**Shpallur me dekretin nr. 276, datë 30.7.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.**

MARRËVESHJE
**PËR THEMELIMIN E ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË VRESHTARISË DHE
VERËS**

Preambulë

Përmes një Marrëveshjeje Ndërkombëtare, të nënshkruar më 29 nëntor 1924, qeveritë e Spanjës, Francës, Greqisë, Hungarisë, Italisë, Luksemburgut, Portugalisë dhe Tunizisë u mbledhën për të krijuar Zyrën Ndërkombëtare të Verës.

Pas një vendimi të shteteve anëtare të saj, më 4 shtator 1958, zyra u emërua Zyra Ndërkombëtare e Vreshtarisë dhe Verës. Kjo organizatë ndërqeveritare, më datë 3 prill 2001, ka 45 shtete anëtare.

Asambleja e Përgjithshme e Zyrës Ndërkombëtare të Vreshtarisë dhe Verës, në rezolutën e saj COMEX 2/97, të miraturar në sesionin e mbajtur më 5 dhjetor 1997 në Buenos-Aires (Argjentinë), vendosi të vijonte, sipas nevojës, me përshtatjen e Zyrës Ndërkombëtare të Vreshtarisë dhe Verës në mjedisin e ri ndërkombëtar. Kjo përfshiu përshtatjen e misionit të saj, burimeve njerëzore, materiale dhe buxhetore dhe, sipas rastit, procedurave dhe rregullave të saj të veprimit, në mënyrë që të përballojë sfidat dhe të sigurojë të ardhmen e sektorit botëror viti-vinifikues.

Në zbatim të nenit 7 të Marrëveshjes së sipërpërmendur, Qeveria e Republikës Franceze, në vijim të një kërkesë nga 36 shtetet anëtare, organizoi një Konferencë të shteteve anëtare më 14, 15, 22 qershor 2000 dhe më 3 prill 2001, në Paris.

Për këtë qëllim, shtetet anëtare të Zyrës Ndërkombëtare të Vreshtarisë dhe Verës, në vijim “Palët”, kanë rënë dakord si më poshtë:

KAPITULLI I
OBJEKTIVAT DHE VEPRIMTARITË

Neni 1

1. Themelohet “Organizata Ndërkombëtare e Vreshtarisë dhe Verës” (O.I.V). O.I.V do të zëvendësojë Zyrën Ndërkombëtare të Vreshtarisë dhe Verës, të themeluar me Marrëveshjen e 29 nëntorit 1924, e ndryshuar, dhe do t’u nënshtrohet dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

2. O.I.V do të vijojë me objektivat e saj dhe do të ushtrojë aktivitetet e saj të përcaktuara në nenin 2. O.I.V do të jetë një organizatë ndërqeveritare me natyrë shkencore dhe teknike të njohur për kompetencën e saj në funksion të vreshtarisë, verës, pijeve me bazë verën, rrushin, rrushin e thatë dhe produkte të tjera të vreshtarisë.

Neni 2

1. Në kuadër të kompetencës së saj, objektivat e O.I.V janë si më poshtë:

a) të informojë anëtarët e saj mbi masat që mund të merren ndaj prodhuesve, konsumatorëve dhe aktorëve të tjerë të sektorit të produkteve viti-vinifikuese;

b) të mbështesë organizatat e tjera ndërkombëtare, si ato ndërqeveritare ashtu edhe joqeveritare, veçanërisht ato që kryejnë veprimtari standardizimi;

c) të kontribuojë në harmonizimin ndërkombëtar të praktikave dhe standardeve ekzistuese dhe, sipas nevojës, në përgatitjen e standardeve të reja ndërkombëtare, në mënyrë që të përmirësohen kushtet për prodhimin dhe marketimin e produkteve të vreshtarisë dhe verës dhe të të mund të sigurojë që interesat e konsumatorëve të jenë marrë në konsideratë.

2. Për të arritur këta objektiva, aktivitetet e O.I.V do të jenë si vijon:

a) të promovojë dhe të udhëheqë hulumtimin tekniko-shkencor dhe eksperimentimin, në mënyrë që të plotësojë nevojat e shprehura nga anëtarët e saj, të vlerësojë rezultatet, duke kërkuar ekspertë të kualifikuar kur është e nevojshme, dhe në rastin e duhur të shpërndajë rezultatet me mjete të përshtatshme;

b) të hartojë dhe të formulojë rekomandime dhe të ndjekë zbatimin e tyre në lidhje me anëtarët e saj, veçanërisht në fushat e mëposhtme:

i. kushtet për prodhimin e rrushit;

ii. praktikat enologjike;

iii. përcaktimi dhe/ose përshkrimi i produkteve, etiketat dhe kushtet e marketingut;

iv. metodat për analizimin dhe vlerësimin e produkteve të vreshtarisë;

c) të paraqesë para anëtarëve të saj të gjitha propozimet që lidhen me:

i. garantimin e autenticitetit të produkteve të vreshtarisë, specifikisht në lidhje me konsumatorët, në veçanti, në përputhje me informacionin e dhënë në etiketa;

ii. mbrojtjen e treguesve gjeografikë, veçanërisht të zonave të prodhimit të vreshtarisë dhe verës dhe emërtimeve të tyre të origjinës, qoftë të shpallura me emra gjeografikë ose jo, në mënyrë që të mos vihen në pikëpyetje marrëveshjet ndërkombëtare që lidhen me tregtinë dhe pronësinë intelektuale;

iii. përmirësimin e kriterëve shkencore dhe teknike për njohjen dhe mbrojtjen e varieteteve të reja të bimëve viti-vinifikuese;

d) të kontribuojë në harmonizimin dhe përshtatjen e rregullave nga anëtarët e saj ose, kur është e nevojshme, të mundësojë njohjen e ndërsjellë të praktikave në fushën e saj të veprimtarisë;

e) të ndërmjetësojë mes vendeve ose organizatave kur ka kërkesa, me shpenzimet e ndërmjetësimit të bartura nga ata që bëjnë kërkesën;

f) të monitorojë, të vlerësojë dhe të informojë anëtarët e saj në kohën e duhur kur zhvillimet shkencore ose teknike të kenë efekte të rëndësishme dhe -afatgjata në sektorin e verës;

g) të ndihmojë në mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve dhe të kontribuojë në sigurinë ushqimore:

i. me monitorimin shkencor të specializuar, që e mundëson vlerësimin e karakteristikave të veçanta të produkteve të vreshtarisë;

ii. duke promovuar dhe udhëhequr hulumtimin shkencor për vlerat e duhura ushqimore dhe shëndetësore;

iii. duke zgjeruar shpërndarjen e informacionit që rezulton nga kërkime të tilla shkencore, pavarësisht përfituesve të referuar në nenin 2, paragrafi n, te profesionistët mjekësorë dhe të kujdesit shëndetësor;

h) të promovojë bashkëpunimin mes anëtarëve përmes:

i. bashkëpunimit administrativ;

ii. shkëmbimit të informacionit specifik;

iii. shkëmbimit të ekspertëve;

iv. ofrimit të ndihmës ose këshillimit me ekspertë, veçanërisht për krijimin e projekteve të përbashkëta dhe bashkëpunimeve për kërkime të tjera shkencore;

i) të marrë në konsideratë në aktivitetet e saj tiparet e veçanta të sistemeve të secilit prej anëtarëve të saj për prodhimin e produkteve të vreshtarisë dhe metodat për prodhimin e verave dhe pijeve alkoolike me bazë rrushi dhe vere;

j) të kontribuojë në zhvillimin e rrjeteve të trajnimit të lidhura me verën dhe produktet e vreshtarisë;

k) të kontribuojë në promovimin ose njohjen e trashëgimisë botërore të vreshtarisë dhe verës dhe të aspekteve historike, kulturore, njerëzore, sociale dhe mjedisore të saj;

l) të sigurojë mbikëqyrjen e saj për evente publike ose private me qëllime jofitimprurëse, të cilat janë pjesë e fushës së saj të kompetencës;

m) të nxisë një dialog të përshtatshëm në kontekstin e punës së saj, sipas nevojës, me aktorët e sektorit, dhe të përfundojë marrëveshjet e duhura me ta;

n) të mbledhë, të përpunojë dhe të shpërndajë informacionin më të përshtatshëm dhe t'ua komunikojë atë:

i. anëtarëve dhe vëzhguesve të saj;

ii. organizatave të tjera ndërkombëtare, ndërqeveritare dhe joqeveritare;

iii. prodhuesve, konsumatorëve dhe aktorëve të tjerë në sektorin e vreshtarisë dhe verës;

iv. vendeve të tjera të interesuara;

v. medias dhe publikut të gjerë.

Për të lehtësuar rolin e saj si burim informacioni dhe komunikimi, O.I.V mund të kërkojë nga anëtarët e saj, përfituesit potencialë dhe, kur është e nevojshme, nga organizatat ndërkombëtare, që t'i japin informacion dhe të dhëna në bazë të kërkesave të arsyeshme;

o) të rivlerësojë rregullisht efektivitetin e strukturave dhe procedurave të saj të punës.

KAPITULLI II ORGANIZATA

Neni 3

1. Organet e O.I.V do të jenë:

a) Asambleja e Përgjithshme;

b) presidenti;

c) zëvendëspresidentët;

d) drejtori i përgjithshëm;

e) Komiteti Ekzekutiv;

f) Komiteti Shkencor dhe Teknik;

g) Komiteti Drejtues;

h) komisionet, nënkomisionet dhe grupet e ekspertëve;

i) Sekretariati.

2. Secili anëtar i O.I.V do të përfaqësohet nga delegatët e zgjedhur nga vetë ata. Asambleja e Përgjithshme do të jetë organi legjislativ i O.I.V dhe do të përbëhet nga delegatë të emëruar nga anëtarët. Asambleja e Përgjithshme mund të delegojë disa nga kompetencat e saj te Komiteti Ekzekutiv, i cili do të përbëhet nga një delegat për çdo shtet anëtar. Komiteti Ekzekutiv, nën autoritetin e tij, mund të delegojë disa nga kompetencat administrative të tij Komitetit Drejtues të O.I.V-së, i cili do të përbëhet nga Presidenti dhe zëvendëspresidentët e O.I.V-së dhe presidentët e komisioneve dhe nënkomisioneve të O.I.V-së. Presidenti, zëvendëspresidenti i parë dhe presidentët e komisioneve duhet të jenë të kombësive të ndryshme.

3. O.I.V-ja do të kryejë aktivitetin shkencor përmes grupeve të ekspertëve, nënkomisioneve dhe komisioneve, të koordinuara nga një Komitet Shkencor dhe Teknik, brenda kornizës së një plani strategjik të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme.

4. Drejtori i përgjithshëm do të jetë përgjegjës për administrimin e brendshëm të O.I.V-së dhe për rekrutimin dhe menaxhimin e personelit. Procedurat për rekrutimin e personelit duhet të sigurojnë, sa është e mundur, karakterin ndërkombëtar të organizatës.

5. O.I.V-ja mund të përfshijë edhe vëzhgues. Vëzhguesit do të pranohen vetëm pas dakordësisë me shkrim për dispozitat e përfshira në këtë Marrëveshje dhe në rregulloren e brendshme.

6. Selia e organizatës do të jetë në Paris (Francë).

KAPITULLI III TË DREJTAT E VOTËS

Neni 4

Secili anëtar do të përcaktojë numrin e delegatëve të tij, por do të ketë vetëm dy vota të thjeshta, plus kur është e nevojshme, një numër shtesë votash të përlllogaritura nga kriteret objektive që përcaktojnë pozicionin relativ të secilit nga shtetet anëtare në sektorin e vreshtarisë dhe verës nën kushtet e përcaktuara në anekset 1 dhe 2 të kësaj Marrëveshjeje, të cilat janë pjesë përbërëse e saj. Shuma e këtyre dy shifrave do të përbëjë numrin e votave të ponderuara. Koeficienti që përcakton pozicionin e secilit shtet anëtar në sektorin e vreshtarisë dhe verës do të përditësohet rregullisht në përputhje me dispozitat në aneksin I.

KAPITULLI IV METODAT E PUNËS, PROCESET VENDIMMARRËSE

Neni 5

1. Asambleja e Përgjithshme do të jetë organi më i lartë i O.I.V-së. Ajo do të diskutojë dhe do të miratojë rregulloret lidhur me organizimin dhe punën e O.I.V-së dhe projektrezoluta të një natyre të përgjithshme, shkencore, teknike, ekonomike ose ligjore, si dhe për krijimin ose ndërprerjen e komisioneve dhe nënkomisioneve. Ajo do të vendosë buxhetin për të ardhurat dhe shpenzimet brenda tavaneve të ndarjeve ekzistuese buxhetore dhe do të auditojë dhe miratojë llogaritë. Asambleja e Përgjithshme do të miratojë protokollet e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit për çështje që kanë të bëjnë me produktet e vreshtarisë dhe verës që O.I.V-ja mund të nënshkruajë me organizatat ndërkombëtare. Ajo do të mbledhet një herë në vit. Seancat e jashtëzakonshme mund të thirren me kërkesë të një të tretës së anëtarëve të O.I.V-së.

2. Delegatët nga një e treta e anëtarëve që përfaqësojnë të paktën gjysmën e votave të ponderuara duhet të jenë të pranishëm që të konsiderohet seanca e vlefshme. Përfaqësimi i një anëtarit mund t'i besohet delegacionit të një anëtarit tjetër, por një delegacion mund të ushtrojë vetëm një përfaqësim përveç atij të tij.

3. a) Konsensusi do të jetë metoda normale me të cilën Asambleja e Përgjithshme do të miratojë projektrezoluta të natyrës së përgjithshme, shkencore, teknike, ekonomike ose ligjore, si dhe për krijimin ose ndërprerjen e komisioneve dhe nënkomisioneve. E njëjta gjë vlen edhe për Komitetin Ekzekutiv kur ai ushtron funksionet e tij në këto çështje.

b) Konsensusi nuk do të kërkojë për zgjedhjen e Presidentit të O.I.V-s, presidentëve të komisioneve dhe nënkomisioneve ose për drejtorin e përgjithshëm, as edhe për buxhetin ose kontributet financiare të anëtarëve. Po ashtu, ai nuk do të aplikohet për vendimet e tjera financiare të përcaktuara në rregullat e brendshme.

c) Në rastet kur Asambleja e Përgjithshme ose Komiteti Ekzekutiv nuk arrijnë në konsensus në rastin e parë për një projektrezolutë ose vendim, Presidenti do të ndërmarrë të gjitha iniciativat për t'u konsultuar me anëtarët në periudhën ndërmjetëse përpara seancës së ardhshme të Asamblesë së Përgjithshme ose të Komitetit Ekzekutiv, për të bashkuar pikëpamjet e ndryshme. Kur të gjitha përpjekjet

për të arritur konsensusin janë shteruar, Presidenti do të ndërmarrë një votim me shumicë të cilësuar, që është një votë e dy të tretave plus një votë e anëtarëve të pranishëm ose të përfaqësuarve, bazuar në parimin një anëtar një votë. Megjithatë, votimi do të shtyhet për një periudhë njëvjeçare nëse një anëtar konsideron që interesat e tij themelore kombëtare janë në rrezik. Votimi nuk do të ndodhë, nëse kundërshtimi konfirmohet me shkrim nga ministri i Punëve të Jashtme ose nga çdo autoritet tjetër kompetent politik i anëtarit të interesuar.

4. a) Presidenti i O.I.V-së, presidentët e komisioneve dhe nënkomisioneve dhe drejtori i përgjithshëm do të zgjidhen me votë me shumicë të cilësuar, dy të tretat plus një nga numri i votave të ponderuara të anëtarëve të pranishëm ose të përfaqësuar, me kusht që gjysma plus një e anëtarëve të pranishëm ose të përfaqësuar të kenë votuar për kandidatin. Nëse këto kushte nuk plotësohen, do të organizohet një seancë e jashtëzakonshme e Asamblesë së Përgjithshme brenda një periudhe deri në tre muaj. Gjatë kësaj periudhe dhe, sipas rastit, Presidenti, kryetarët e komisioneve dhe nënkomisioneve dhe drejtori i përgjithshëm në detyrë i ruajnë përgjegjësitë e tij/saj.

b) Presidenti i O.I.V-së, presidentët e komisioneve dhe nënkomisioneve do të zgjidhen për një mandat trevjeçar. Drejtori i përgjithshëm do të zgjidhet për një mandat pesëvjeçar; drejtori i përgjithshëm mund të rizgjidhet edhe për një mandat tjetër pesëvjeçar, me të njëjtat kushte që rregulluan mandatin e tij të parë. Asambleja e Përgjithshme mund të revokojë mandatin e drejtorit të përgjithshëm në çdo kohë në të njëjtat kushte që rregulloi zgjedhjen e tij, sipas vendimit të shumicës së ponderuar dhe shumicës së cilësuar të shteteve anëtare.

5. Votimi për buxhetin dhe kontributet financiare të anëtarëve bëhet me shumicë të cilësuar të ponderuar, pra, dy të tretat plus një të votave të ponderuara të anëtarëve të pranishëm ose të përfaqësuar. Asambleja e Përgjithshme emëron një auditues, me propozim të përbashkët të drejtorit të përgjithshëm dhe Komitetit Drejtues të O.I.V-së, me aprovim nga Komiteti Ekzekutiv.

6. Gjuhët zyrtare janë: gjuha frënge, gjuha spanjolle dhe gjuha angleze. Financimi i tyre përcaktohet në aneksin nr. 2 të kësaj Marrëveshjeje. Megjithatë, Asambleja e Përgjithshme mund ta përshtatë, nëse është e nevojshme, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 3/a. Me kërkesë të një ose më shumë anëtarëve, gjuhë të tjera do të shtohen sipas së njëjtës metode financimi, veçanërisht gjuha italiane dhe gjuha gjermane, për të përmirësuar komunikimin mes anëtarëve. Paraprakisht, përdoruesit e interesuar duhet të kenë pranuar zyrtarisht kontributin e tyre të ri financiar, pas kërkesës së bërë për shtimin e gjuhës. Përveç pesë gjuhëve, çdo kërkesë e re i paraqitet Asamblesë së Përgjithshme, e cila merr vendimin sipas kushteve të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 3/a. Frëngjishtja do të mbetet gjuha e referencës në rast mosmarrëveshjeje me palë të treta, që nuk janë anëtare të organizatës.

7. Organet përbërëse të O.I.V-së do të funksionojnë në mënyrë të hapur dhe transparente.

KAPITULLI V FINANCIMI I O.I.V-së

Neni 6

1. Çdo anëtar i O.I.V-së do të paguajë një kontribut financiar që vendoset çdo vit nga Asambleja e Përgjithshme, shuma e të cilit do të përcaktohet duke zbatuar dispozitat e anekseve 1 dhe 2 të kësaj Marrëveshjeje. Asambleja e Përgjithshme do të vendosë kontributin financiar të anëtarëve të rinj në bazë të dispozitave të anekseve 1 dhe 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Burimet financiare të O.I.V-së përfshijnë kontributin vjetor të detyrueshëm të çdo anëtari dhe vëzhguesi, si dhe rezultatet e veprimtarisë së saj. Pagesat detyruese do t'i paguhet O.I.V-së gjatë vitit kalendarik të caktuar. Përtej kësaj kohe, pagesa do të konsiderohet e vonuar.

3. Burimet financiare të O.I.V-së mund të përfshijnë gjithashtu kontribute vullnetare nga anëtarët e saj, donacione, grante, subvencione ose financime të çdo lloji nga organizatat ndërkombëtare dhe kombëtare të natyrës publike, gjysmëpublike ose private, me kusht që ky financim të jetë në përputhje me parimet e përgjithshme të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme, në përputhje me dispozitat e nenit 5, paragrafi 3/a, i cili do të integrohet në rregulloren e brendshme.

Neni 7

1. Nëse një anëtar nuk paguan dy kontribute, të drejtat e votimit dhe pjesëmarrjes së tij, në mbledhjen e ardhshme të Komitetit Ekzekutiv dhe Asamblesë së Përgjithshme pas konstatimit të kësaj shkeljeje, do të pezullohen automatikisht. Komiteti Ekzekutiv cakton rast pas rasti kushtet në të cilat anëtarët e interesuar mund të rregullojnë situatën e tyre ose, nëse kjo nuk ndodh, të konsiderohen se kanë denoncuar Marrëveshjen.

2. Në rastin që tri kontribute të radhës nuk janë paguar, drejtori i përgjithshëm do të njoftojë anëtarin ose vëzhguesin e interesuar për këtë situatë. Nëse situata nuk rregullohet gjatë dy vjetëve të ardhshëm pas 31 (tridhjetë e një) dhjetorit të vitit të tretë, anëtari ose vëzhguesi i interesuar do të përjashtohet automatikisht.

KAPITULLI VI PJESËMARRJA E ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE NDËRQEVERITARE

Neni 8

Një organizatë ndërkombëtare ndërqeveritare mund të marrë pjesë ose të jetë anëtar i O.I.V-së dhe mund të ndihmojë në financimin e O.I.V-së sipas kushteve të përcaktuara, rast pas rasti, nga Asambleja e Përgjithshme me propozimin e Komitetit Ekzekutiv.

KAPITULLI VII NDRYSHIMI DHE RISHIKIMI I MARRËVESHJEVE

Neni 9

1. Çdo anëtar mund të propozojë ndryshime në këtë Marrëveshje. Propozimi duhet t'i bëhet me shkrim drejtorit të përgjithshëm dhe ai ua bën të ditur të gjithë anëtarëve të tjerë të organizatës. Nëse brenda gjashtë muajve, nga data e komunikimit, gjysma e anëtarëve plus një janë dakord, drejtori i përgjithshëm ia paraqet për vendim Asamblesë së Përgjithshme në mbledhjen e parë që zhvillohet në fund të kësaj periudhe. Vendimi merret me konsensus të anëtarëve të pranishëm ose të përfaqësuar. Pas miratimit nga Asambleja e Përgjithshme, ndryshimet do të jenë subjekt i procedurave të brendshme të pranimit, miratimit ose ratifikimit, të parashikuara në legjislacionin kombëtar të vendeve anëtare. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi tridhjetë ditë pas depozitimit të instrumentit të pranimit, miratimit, ratifikimit ose aderimit që përfaqëson dy të tretat plus një të anëtarëve të organizatës.

2. Rishikimi i kësaj Marrëveshjeje bëhet me ligj nëse dy të tretat plus një të anëtarëve miratojnë kërkesën. Në këtë rast, një Konferencë e anëtarëve thirret nga Qeveria e Republikës Franceze brenda gjashtë muajve. Programi, si dhe rishikimi i propozuar do t'iu jepen anëtarëve të paktën dy muaj para mbajtjes së konferencës. Konferenca do të vendosë rregullat e procedurës. Drejtori i përgjithshëm i O.I.V-së do të veprojë si Sekretari i Përgjithshëm.

3. Para se një marrëveshje e rishikuar të hyjë në fuqi, Asambleja e Përgjithshme e organizatës do të përcaktojë, sipas kushteve të përcaktuara nga kjo Marrëveshje dhe nga rregullat e brendshme të përmendura në nenin 10, deri në çfarë mase anëtarët e përfshirë në këtë Marrëveshje, të cilët nuk kanë depozituar një instrument të pranimit ndryshimi, ratifikimi ose aderimi mund të marrin pjesë në aktivitetet e O.I.V-së pas hyrjes në fuqi të saj.

KAPITULLI VIII RREGULLAT E BRENDSHME

Neni 10

Asambleja e Përgjithshme miraton rregullat e brendshme të O.I.V-së, të cilat përcaktojnë kur është e nevojshme, kushtet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje. Deri në këtë miratim, rregullat e Zyrës Ndërkombëtare të Vreshtarisë dhe Verës do të aplikohen për O.I.V-në. Rregullorja përcakton në veçanti

detyrat, metodat e funksionimit të organeve të përmendura në nenet e mëparshme, kushtet e pjesëmarrjes së vëzhguesve, si dhe metodat në lidhje me shqyrtimin e rezervave të propozuara që mund të formulohen në lidhje me këtë Marrëveshje, dhe dispozitat që kanë të bëjnë me menaxhimin administrativ dhe financiar të O.I.V-së. Ata do të përshkruajnë, gjithashtu, kushtet për komunikimin e dokumenteve, veçanërisht atyre që lidhen me financimin, tek anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme dhe Komitetit Ekzekutiv para marrjes së vendimeve.

KAPITULLI IX DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 11

O.I.V. do të ketë personalitet juridik dhe secili prej anëtarëve të saj do t'i japë atij zotësinë juridike të nevojshme për të ushtruar kompetencat e tij.

Neni 12

Mund të formulohen propozime mbi rezervat për këtë marrëveshje. Propozimet duhet të pranohen nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me dispozitat e nenit 5, paragrafi 3/a.

Neni 13

Kjo Marrëveshje është e hapur për nënshkrim nga të gjithë Shtetet Anëtare të Zyrës Ndërkombëtare të Vreshtarisë dhe Verës deri më 31 korrik 2001. Kjo Marrëveshje do të jetë subjekt i pranimit, miratimit, ratifikimit ose aderimit.

Neni 14

Çdo shtet që nuk përmendet në nenin 13 të kësaj Marrëveshjeje mund të aplikojë për t'u bërë pjesë si anëtar. Aplikimet për anëtarësim i dërgohen drejtpërdrejt O.I.V-së, me një kopje në Qeverinë e Republikës Franceze, e cila ua njofton ato shteteve ose palëve nënshkruese të kësaj Marrëveshjeje. O.I.V informon anëtarët e saj për kërkesat e paraqitura dhe për çdo vërejtje të mundshme të bërë. Anëtarët kanë gjashtë muaj kohë për të bërë të ditur mendimin e tyre tek O.I.V. Në fund të periudhës gjashtëmujore, anëtarësimi pranohet nëse shumica e anëtarëve nuk kundërshtojnë aplikimin. Depozituesi do të njoftojë Shtetin aplikues për rezultatin e aplikimit të tij. Nëse aplikimi është i suksesshëm, shteti i cili ka aplikuar ka dymbëdhjetë muaj kohë për të depozituar instrumentin e aderimit. Çdo shtet i përmendur në nenin 13, i cili nuk e ka nënshkruar këtë Marrëveshje brenda afateve kohore të përcaktuara, mund të aderojë në të në çdo kohë.

Neni 15

Instrumentet e pranimit, miratimit, ratifikimit ose aderimit do të depozitohen te Qeveria e Republikës Franceze, e cila do t'i njoftojë nënshkruesit dhe Palët e kësaj Marrëveshjeje për këto instrumente. Instrumentet e pranimit, miratimit, ratifikimit ose aderimit do të arkivohen në arkivat e Qeverisë së Republikës Franceze.

Neni 16

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të vitit pasues pas depozitimit të tridhjetë e një instrumenteve të pranimit, aprovimit, ratifikimit ose aderimit.

2. Për çdo shtet që pranon, miraton ose ratifikon këtë Marrëveshje ose aderon në të pas datës së hyrjes në fuqi, kjo Marrëveshje do të zbatohet në ditën e tridhjetë pas depozitimit nga ai shtet të instrumentit të tij të pranimit, miratimit, ratifikimit ose aderimit.

3. Asambleja e Përgjithshme e Zyrës Ndërkombëtare të Vreshtarisë dhe Verës përcakton, sipas kushteve të përcaktuara nga Marrëveshja e ndryshuar më 29 nëntor 1924 dhe nga rregulloret e brendshme që rrjedhin prej saj, në çfarë mase shtetet palë në Marrëveshjen e sipërpërmendur që nuk kanë depozituar një instrumenti i pranimit, miratimit, ratifikimit ose aderimit mund të marrin pjesë në aktivitetet e O.I.V, pas datës së hyrjes në fuqi.

Neni 17

1. Marrëveshja e 29 nëntorit 1924, e ndryshuar, do të përfundojë me vendim unanim të Asamblesë së të parë të Përgjithshme që do të mbledhet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, përveç rastit kur të gjitha palët në marrëveshjen e sipërpërmendur kanë rënë dakord unanimit përpara hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje,, mbi kushtet për shfuqizimin e saj.

2. “Organizata Ndërkombëtare e Vreshtarisë dhe Verës” do të zëvendësojë Zyrën Ndërkombëtare të Vreshtarisë dhe Verës në lidhje me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e saj.

Neni 18

Çdo Palë në këtë Marrëveshje mund ta denoncojë atë me shkrim, në çdo kohë brenda gjashtë muajve, drejtuar drejtorit të përgjithshëm të O.I.V-së dhe Qeverisë së Republikës Franceze. Çdo vëzhgues mund të vendosë të tërhiqet nga organizata në çdo kohë, brenda gjashtë muajve, duke i dërguar një njoftim me shkrim drejtorit të përgjithshëm të O.I.V.

Neni 19

Originali i kësaj Marrëveshjeje, në të cilën teksti francez, spanjoll dhe anglez janë autentikë, do të depozitohen te Qeveria e Republikës Franceze.

NË DËSHMI TË KËSAJ, të nënshkruarit duke qenë të autorizuar nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar Marrëveshjen për themelimin e “Organizatës Ndërkombëtare të Vreshtarisë dhe Verës (O.I.V)”, **3 prill 2001**.

Aneksi 1, i cili është i përmendur në nenet 4 dhe 6 të kësaj Marrëveshjeje

Metoda për përcaktimin e pozicionit të secilit shtet anëtar në sektorin e vreshtarisë dhe verës.

1. Kriteret objektive që përcaktojnë pozicionin relativ të çdo shteti anëtar në sektorin e vreshtarisë dhe verës janë si vijon:

a) prodhimi mesatar i verës, verave të veçanta, mushtit, pijeve alkoolike me origjinë të rrushit dhe verës (të shprehur në ekuivalentë vere) në periudhën e fundit pesëvjeçare të njohur, pas eliminimit të dy vlerave ekstreme (P);

b) mesataren e sipërfaqes totale të vreshtarisë në periudhën e fundit trevjeçare (S);

c) konsumi i dukshëm mesatar i verës dhe ekuivalent i verës në periudhën e fundit trevjeçare (C) = (P) prodhim - E (eksportet) + I (importet).

2. Formula për përcaktimin e koeficientit për secilin shtet anëtar:

$$X \% = (0.60 P \text{ (shteti anëtar)} + 0.20 S \text{ (shteti anëtar)} + 0.20 C \text{ (shteti anëtar)}) / 100$$

P (totali i O.I.V) S (totali i O.I.V) C (totali i O.I.V)

3. Koeficienti i çdo shteti anëtar përditësohet:

a) në fillim të vitit të buxhetor pas hyrjes së një anëtari të ri;

b) çdo tre vjet duke marrë parasysh të dhënat e fundit statistikore.

4. Anëtarë të rinj:

Anëtarë të rinj që do t'i bashkohen O.I.V-së në vitet e ardhshme duhet të paguajnë një kontribut financiar të detyrueshëm i llogaritur sipas formulës të përcaktuar në këtë aneks, me shtimin e pjesëmarrjes së tyre në financimin e gjuhëve specifike, në kushtet e caktuara në aneksin 2.

Aneksi 2 përmendur në nenet 4, 5 dhe 6 të kësaj Marrëveshjeje

Metoda për përcaktimin e të drejtave të votimit të shteteve anëtare, kontributeve financiare të detyrueshme dhe metoda për financimin e gjuhës.

1. Votat bazë:

Secili shtet anëtar ka dy vota bazë.

2. Vota shtesë:

Numri total i votave shtesë është i barabartë me gjysmën e numrit total të votave bazë. Deri në këtë masë, votat shtesë ndahen sipas rastit, përveç votave bazë të disa shteteve anëtare të caktuara sipas pozitës së tyre relative në sektorin e vreshtarisë dhe verës, sipas formulës së dhënë në aneksin 1.

3. Vota të ponderuara:

Numri i votave të ponderuara të secilit shtet anëtar është i barabartë me shumën e votave të tyre bazë dhe votave shtesë, në qoftë se ka.

4. Përcaktimi i kontributeve të detyrueshme:

Shuma totale e kontributeve të detyrueshme të paguara nga anëtarët llogaritet në bazë të buxhetit të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme.

Një të tretën e shumës totale të kontributeve të detyrueshme ndahet në mënyrë të barabartë midis votave bazë.

Dy të tretat e shumës totale të kontributeve të detyrueshme ndahen në proporcion të votave shtesë.

Për të lehtësuar tranzicionin mes Marrëveshjes së mëparshme dhe aktuale, kontributi financiar përkatës dy votave bazë të çdo shteti anëtar nuk mund të jetë më i ulët, për vitin e parë buxhetor, se “Njësia e kontributeve” para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Nëse është e nevojshme, shuma e kontributeve financiare për votat shtesë përshtatet në përputhje me këtë që të arrihet shuma totale e kontributeve të detyrueshme të caktuara nga buxheti i miratuar.

5. Financimi i gjuhëve:

Financimi i gjuhës sigurohet plotësisht nga ndarja në buxhetin e përgjithshëm të O.I.V-së dhe pa një kontribut specifik nga secili grup gjuhësor i përbërë nga anëtarë dhe vëzhgues përdorues. Kushtet e zbatimit të gjuhëve do të jenë objekt i dispozitave specifike të përcaktuara në rregulloren e brendshme.